



**I PAHARRUARI
HOXHA I JONË,
SHEJKH VEHBİ S. GAVOÇI!**



**A JANË RITET E HAXHIT
IDHUJTARI?**



**PROJEKTI "VETJA" – NJË
INVESTIM DOBIPRURËS**

UDHA ISLAME

Viti 20 - Nr. 2 (228), Shkurt, 2022

www.myftinia-shkoder.org

Botim i Myftinisë Shkodër
E përmuajshme
Informative - Fetare
Kulturore - Edukative



MYFTINIASHKODER1990

"Të qëndrojmë në besën e të parëve,

*të shëmbëlltyrës së tyre në dije, në shkollim,
në bamirësi dhe në ruajtjen e tabanit shekullor islam..."*



NË KUJTIM TË HOXHËS H. VEHBİ S. GAVOÇI, DIJETARIT MË FAMË BOTËRORE

Më 21 shkurt 2022, Myftinia Shkodër në bashkëpunim me Medresenë "Haxhi Sheh Shamia", organizoi një aktivitet përkujtimor në 9 vjetorin e ndërrimit jetë të dijetarit H. Vehbi S. Gavoçi.



Krahas maturantëve dhe mësuesve të shkollës, të pranishëm ishin edhe Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed Sytari, drejtori i medresesë, z. Kujtim Dervishi, koordinatori i shoqatës "Istanbul", pranë kësaj shkolle, z. Fehmi Dushku, imamë, etj.

Fillimisht, teologu Arben Halluni gjatë fjalës së ...

(f. 4)

PËRURORHET QENDRA KULTURORE NË BARBULLUSH

Në kuadër të Natës së Madhe të Israsë dhe Miraxhit, ditën e diel, më 27 shkurt 2022, në fshatin Barbullush, u zhvillua ceremonia e përirimit të Qendrës Kulturore, Çelësat e të mirës, pranë xhamisë së kësaj zone.



Nderonin me praninë e tyre: drejtuesi për Ballkanin i fondacionit "Rahmeh International" në Kuvajt, z. Isa Dhewadi, drejtori i fondacionit "Mirësia", z. Korab Kaja, drejtori i fondacionit "Mirënjohja", z. Samed Shehu, etj...

(f. 19)



Imam Muhamed Sytari
Myfti i Zonës Shkodër

Ndër shekuj, muslimanët shkodranë, të vetëdijshëm për rëndësinë dhe peshën e vakëfit në mbarëvajtjen e jetës fetare, sociale e kulturore të shoqërisë, nuk hezituan të dhuronin në këtë drejtim, duke u dëshmuar për bamirësi e solidaritet!

Akoma sot, përmendet në Shkodër: Vakëfi i Shaban efendisë, xhamia e Fushë Çelës (lexo: Çel Zylyftari), fusha e Tabakut, vakfi i Zdrales, çinarët, pusët e hajrateve, e shumë e shumë vakfe të ngjashme në çdo lagje e fshat.

Periudha e ndarjes së detyruar nga Hilafeti i lavdishëm Osman, solli edhe “mëvetësinë” e dhimbshme të Komunitetit Mysliman dhe përpjekjet për organizim, në një realitet të vështirë, me mungesa të theksuara në kuadro e strategji, si dhe nga rreziku i përhershëm i ndikimeve të ndryshme, në kushtet e izolimit!?

Izolimet, përherë krijojnë situata plot turbulenca, humbje ekuilibri dhe devijime, që shpien deri në humbjen e dinjitetit dhe tjetërsimin e boshtit, siç ka rrezik të ndodhë përherë në periudha tranzicionesh!?

Komunizmi i dha një goditje selektive pronave të komuniteteve fetare, duke prishur e shkatërruar xhamitë e medresetë kryesore, duke konfiskuar bibliotekat e shquara muslimane të Shkodrës dhe duke mos lënë, qoftë edhe një xhami të vetme në këmbë, me përjashtim të Xhamisë së Plumbit dhe një aneksi të xhamisë së vjetër të Tophanës, që shërbeu si dyqan vajguri. (Kam qenë i vogël në moshë, kur rrija në radhë me një bidon alumini, për të blerë vajguri në atë vend!).

Pas vitit 1990, nisi rimëkëmbja e Myftinisë Shkodër, ku ndër përparësitë e organizimit ishte edhe rikthimi i vakëfeve të shenjtë. Po si?

Shumë e shumë dosje, akoma sot,

VAKËFET E SHKODRËS JANË KUFI I KUQ!

Vakfet e Shkodrës janë vakfet e Myftinisë Shkodër dhe është përgjegjësi e Myftinisë Shkodër me organizmat e saj trajtimi, vendosja e strategjive, zhvillimi, shfrytëzimi, gjallërimi dhe përfitimi prej tyre brez pas brezi, për të mirën e Thirrjes Islame, aktivitetit bamirës, atij social e më gjerë!

sillen zyra të shtetit, duke mbajtur peng kthimin e tyre final tek i zoti, duke mbajtur peng zhvillimin dhe njëkohësisht, duke dëshmuar dështimin e qeverive të këtyre tre dekadave në kapërcimin me sukses të këtij hendeku të shëmtuar në marrëdhënie me pronat e Myftinisë Shkodër.

Sa e sa premtime, por edhe sa e sa teka e kapriço të papërgjegjshme të drejtuesve të ndryshëm, emrat e të cilëve sot janë harruar, ndonëse në arkivat tonë, janë rrethuar me njolla turpi e mosrespekti, për arrogancën e dëshmuar në hak të një të drejte legjitime, të grabitur, pastaj mohuar e pastaj nëpërkëmbur në hak të muslimanëve shkodranë dhe institucionit të Myftinisë së tyre!

Përtej insinuatave të dallkaukëve misionarë të rrugës, gjatë këtyre dekadave, vakëfet e kthyer janë administruar me përgjegjësi dhe brenda politikës së të mundurës, në kushtet e gati-gati mbijetesës! Nuk janë shitur, as tjetërsuar vakëfet e Shkodrës! Kush thotë të kundërtën, gënjen!

Nuk e ka humbur vakëfi e xhamia e jonë pozitën dhe rolin e saj në shoqëri, as në aspektin social, as në atë kulturor, as bamirës e më gjerë, siç lexojmë andej-këndeje në tribuna të dëshpëruara!?

Duhet vlerësuar në kufijtë e konteksteve të kohës dhe politikës së ditës, mundi dhe kontributi i myftilerëve të nderuar të kësaj periudhe: H. Faik Hoxha, H. Bashkim Bajraktari, Imam Ndrichim Sulejman, z. Ernal Nurja për çdo përpjekje në këtë drejtim.

Janë kthyer shumë e shumë vakëfe, pjesa më e madhe e të cilëve janë mbajtur peng deri vonë, duke mos u legalizuar ndërtimet e reja mbi të njëjtat vakfe shekullore, duke u nëpërkëmbur procesi i pajisjes me certifikatë të rregullt pronësie, por edhe duke u legalizuar ndërtime pa leje mbi vakfet tona, në mënyrë flagrante e ilegjitime dhe me mbështetje politike..!?

Vetëm në harkun e vitit të fundit, falë

përpjekjeve dhe takimeve të shumta të zhvilluara me faktorë të ndryshëm, kemi arritur të certifikojmë vakëfe të vjetra e shekullore me vlerë për ne, si: vakfi i rrethuar i Fushë Çelës, Kompleksi i Medresesë së djemve, xhamia e Rusit, por jo vetëm!

Më herët kemi arritur të certifikojmë pronat e shenjtë në Zogaj, te fusha e Tabakut, në Zdralej dhe shumë xhami e vakfe në fshat.

Vakfet e Shkodrës janë vakfet e Myftinisë Shkodër dhe është përgjegjësi e Myftinisë Shkodër me organizmat e saj trajtimi, vendosja e strategjive, zhvillimi, shfrytëzimi, gjallërimi dhe përfitimi prej tyre brez pas brezi, për të mirën e Thirrjes Islame, aktivitetit bamirës, atij social e më gjerë!

Pëshpërimat dhe grricjet që vijnë nga majtas-djathtas, nga qoshke lokale e zyra të hutuarish, në drejtim të vakëfeve tona, janë kakofoni dhe zhurma akustike që i kthejmë mbrapsht, duke i shikuar prej lart poshtë, me habi dhe përbuzje (kur, duhet patjetër të shihen në atë mënyrë)..!?

Detyra e Myftiut të Shkodrës, administratorit, menaxherëve, stafit të brendshëm, imamëve dhe njerëzve të përgjegjshëm, është të lobojnë maksimalisht e të përpiqen në mënyrë të organizuar për zhvillimin e mëtejshëm të vakëfeve të Shkodrës, që nuk kanë qenë e nuk mund të jenë kurrë “mall vakuf” në ambicet e dallkaukëve dhe njerëzve të vegjël, sado të afërt a të largët që të jenë!

Fuqizimi i vakëfit dhe zhvillimi i tij i jep jetë aktivitetit dhe krijon mundësi të daljes nga bataku mjeran i “mëvetësisë” së varur dhe të mbajtur peng!

Vakëfet janë damarë jete, që e kemi për borxh shpirtnor, moral e qytetar t’i mbrojmë me shumë fanatizëm dhe intolerancë, jo “vakuf” misionarësh e lajkatarësh primitivë!

Shkodër, më 19 shkurt 2022

I PAHARRUARI HOXHA I JONË, SHEJKH VEHBİ SULEJMAN GAVOÇI!

Koha kalon, kujtimet ruajnë qetësinë e mallit, gjurmët e diturisë, të përhapura në faqe librash, vazhdojnë të rrezatojnë në çdo shfletim, duke ngritur në piedestalet e nderimit dhe të mirënjohjes, ditë pas dite e kohë pas kohe, imazhin e Dijetarit, Edukatorit, Mësuesit, Shembullit të udhëzuesit drejt moralit të fesë së tij dhe traditave të të parëve, kalorësit të mejdaneve të dijes e trashëgimisë së lidhur brez pas brez e të dalë nga gjokset e burrave besnikë; H. Vehbi Sulejman Gavoçi!



Nuri i shfaqjes së Hoxhës, ditë pas dite shkëlqen, si Diell që na ngroh, edhe pse shpeshherë, si pa dashje e harrojmë, a edhe e neglizhojmë praninë e tij; kujtohem ta kërkojmë, vetëm kur bie shi, a kur qielli e mbulojnë re ngjyrë gri.., ndonëse ai është përherë aty, si një bekim e mëshirë e Allahut për ne! Edhe pse drita e tij është përherë aty, tamam si atë ditë të parë të takimit tonë, e atë ditë të fundit të telefonatës, që u mbyll me bekimet dhe lutjet e tij prindërore!

Vitet kalojnë, por lidhja e zemrës nuk e ka humbur fillin, nuk e ka thyer besën, as e ka shkelur premtimin.., vazhdon me bindje e dashuri, durim e sakrificë të mbajë në shpirt torçën e amanetit, duke u përballur me lloj-lloj shfaqjesh e fenomenesh, përherë në besë e me

lutje për t’a forcuar Zoti në çdo rrahje e frymë!

Vitet kalojnë, madhështia e pranisë së Edukatorit vazhdon të dëshmojë mirësinë e Allahut ndaj nesh, fatmirësinë e takimit, bukurinë e shkëndijës së parë të ndezur, që nga momenti i kontaktit të parë të syve dhe, pa dyshim, rrugëtimin me bindje në atë rrugë të vizatuar nga zemra e të Bardhit Hoxhë, këshillat e të cilit na mëkuan për të mos u dorëzuar në rrugëtimet ton të dijes dhe urtësisë..!

Emri i Hoxhës vazhdon të përmendet

përherë e më shumë, plot dinjitet e krenari, në një kohë krizash, dilemash e padrejtësis; në kohët, kur imazhi i Prijësit është mjegulluar e, ku duar të shumta janë përzier për të devijuar rrugën, imazhin, mesazhin, duke e zëvendësuar portetin e Mësuesit tradicional me copëza të ngjitura portretesh artificiale, që s’formojnë dot një imazh..!?

Bukuria jusuflke e shfaqjes Tënde, i Shtrenjti Mësues, mbetet kible për zemrën, dritësim për çdo hap, udhëzim për mendjen e, mbi të gjitha borxh i shpirtit, deri në ditën e kijametit!

Rahmet të pastë Shpirti, i Dritshmi Hoxhë Vehbi Sulejman Gavoçi!

Si djalë, Muhamed B. Sytari.

Shkodër, më 19 shkurt 2022

MYFTIU: “HIXHABI, TABAN DHE SIMBOL KOMBËTAR NDËR SHQIPTARË!”

Paraditën e të shtunës, më 5 shkurt 2022, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari gjatë një interviste dhënë për *RTSh Shkodra* foli për rastet e diskriminimit të besimtareve muslimane, që kohët e fundit janë refuzuar në punë e shkollë për shkak të shamisë islame, që mbajnë në kokë.

Pyetjes së gazetarit, për rastin e një vajze nga Shkodra, e cila është refuzuar nga një subjekt në Shkodër, Myftiu Sytari, ndër të tjera iu përgjigj, se: “Raste të tilla janë një paradoks i madh, jo thjesht për kohën, në të cilën ndodhemi, por për vetë zhvillimin e dijes, kulturës, trashëgimisë, tabanit dhe vlerave në përgjithësi.

Një nga simbolikat më të bukura të prezantimit të shqiptarëve, gjithandej nëpër botë është hixhabi: “A nuk prezantohen sot shqiptarët me simbolikën e Shën Terezës, e cila është një zonjë e mbuluar me hixhabin dhe mbulesën e Marisë Virgjëreshë, ose Merjemit, alejha selam?!”

Në vitin 2022, të mendoj dhe të shoh, se vajza ime me hixhab paragjykohej nga dikush në qytetin tim, apo në Shqipëri kudo qoftë, duket si diçka e palogjikshme dhe e papranueshme, sepse hixhabi dhe mbulesa tek ne, është taban kombëtar. Sepse, nënat tona, gjyset dhe katragjyset tona, për shekuj, muslimane dhe të krishtera, e kanë mbajtur hixhabin”.

Myftiu tha, se një nga simbolikat më të bukura të prezantimit të shqiptarëve, gjithandej nëpër botë është hixhabi: “A nuk prezantohen sot shqiptarët me simbolikën e Shën Terezës, e cila është një zonjë e mbuluar me hixhabin dhe mbulesën e Marisë Virgjëreshë, ose Merjemit, alejha selam?!”

Gjithashtu, Imam Sytari bëri thirrje për shërimin e këtij fenomeni, që për fat të keq po vazhdon e rritet ditë pas dite dhe njëkohësisht ftoi parlamentin shqiptar, që mbase është i vonuar, për të miratuar një projektligj për mbrojtjen e komuniteteve fetare, shenjtërive të besimit dhe dënimit me ligj të diskriminimit për shkaqe fetare, duke ndaluar çdokënd që prek shenjtëritë e tjetrit!

NË KUJTIM TË HOXHËS H. VEHBİ S. GAVOÇI, DIJETARIT MË FAMË BOTËRORE

"Pa dyshim Haxhi Vehbi Gavoçi ka qenë shtylla kurrizore e aktiviteteve fetare të Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, pas viteve 90', sepse përmes këtyre disa librave dhe botimeve të tija që janë prezent në këtë ekspozitë, janë libra që njerëzit dhe ne kemi mësuar fenë.

Hoxha rahmet pastë përveç një dijetar e shkollor i vëmendshëm, një prind prej të cilit jemi rritur nga prania e dijes dhe edukata që na ka dhanë, ka qenë shumë kurajoz për ta ruajtur tabanin fetar të Shkodrës, por edhe të Shqipërisë nga preket e jashtme, pikërisht ndaj atyre që synojnë tabanin, që synojnë thelbin, që synojnë mbrapshtimin e tryezës së besimit dhe adhurimit." - Hafiz Sabri Koçi

Më 21 shkurt 2022, Myftinia Shkodër në bashkëpunim me Medresenë "Haxhi Sheh Shamia", organizoi një aktivitet përkujtimor në 9 vjetorin e ndërrimit jetë të dijetarit H. Vehbi S. Gavoçi.

Krahas maurantëve dhe mësuesve të shkollës, të pranishëm ishin edhe Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed Sytari, drejtori i medresesë, z. Kujtim Dervishi, koordinatori i shoqatës "Istanbul", pranë kësaj shkolle, z. Fehmi Dushku, imamë, etj.



Fillimisht, teologu Arben Halluni gjatë fjalës së hapjes bëri një prezantim të shkurtër të jetës dhe veprës të hoxhës së nderuar.

"H. Vehbi Gavoçi, ka lindur më 17 maj 1923 në lagjen Garuc të Shkodrës. Në qershor të vitit 1937, ai së bashku me babën e tij, Sulejman Gavoçin, si dhe me gjithë familjen mërguan në Damask të Sirisë.

Në moshën trembëdhjetë vjeçare, shkon në Kajro të Egjiptit, që të kryente shkollën dhe studimet në Universitetin e Al-Az'herit, shkolla më me famë e botës islame në atë kohë. Pas dhjetë viteve qëndrimi në Egjipt, ku kreu fakultetin e Sheriatit dhe dy vite për drejtësi, në vitin 1947, H. Vehbia u kthye në Siri, ndërsa në vitin 1949 fillon punën si mësues në shkollat e vajzave të qytetit të Halepiti deri në vitin 1951.

Më pas, shkon në Damask, ku punon deri në vitin 1965 si mësues në shkollë të ndryshme, si pedagog i institutit që përgatiste mësues si dhe në Universitetin e Damaskut.

Pas vdekjes së babait në vitin 1958, në Siri, H. Vehbiu e zëvendësoi duke dhënë ligjërata në xhaminë "Arnaut", ndërtuar nga i ati. Për tre vjet në këtë xhami Vehbiu ishte imam dhe vaiz, pastaj ligjëron në xhamitë "Esh-Shemsije", "Randa" etj.

shërbeu si mësues deri në vitin 1980.

Më pas ai merr përsëri rrugën për në Arabinë Saudite, ku shërbeu si studiues në Universitetin Islamik të Medinës, pastaj nga Arabia Saudite shkoj në Jordani për tre vjet, ku dha kontributin e tij në punë studimore të ndryshme dhe në botime librash.

Në vitin 1986 u emërua pedagog në Fakultetin Fetar e Gjuhësor në Dubai, të Emirateve të Bashkuara Arabe.

Vdiq më 19 shkurt 2013, në Emiratet e Bashkuara Arabe.

Ka botuar mbi 20 vepra origjinale në gjuhën arabe, si dhe 30 vepra në gjuhën shqipe

Më 10 mars 2012, nga Këshilli Bashkiak i Shkodrës u shpall "Qytetar nderi."

Në vijim, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari në fjalën e tij tha se: "Sot është një ditë e veçantë dhe e begatë për të përkujtuar një prej dijetarëve dhe shkollarëve ma më za shqiptar të shekullit, pa dyshim një nga emrat më të shquara të trojeve tona, në botën arabe dhe islame, H. Vehbi Gavoçi.(rahmet pastë)".

Myftiu tregoi se: "Gjatë një interviste që kam zhvilluar me hafiz Sabri Koçin, e kam pyetur për hoxhën H. Vehbi Gavoçin, për kontributet e tija më është shprehur se: "Pa dyshim Haxhi Vehbi Gavoçi ka qenë shtylla kurrizore



e aktiviteteve fetare të Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, pas viteve 90', sepse përmes këtyre disa librave dhe botimeve të tija që janë prezent në këtë ekspozitë, janë libra që njerëzit dhe ne kemi mësuar fenë. Hoxha rahmet pastë përveç një dijetar e shkollor i vëmendshëm, një prind prej të cilit jemi rritur nga prania e dijes dhe edukata që na ka dhanë, ka qenë shumë kurajoz për ta ruajtur tabanin fetar të Shkodrës, por edhe të Shqipërisë nga preket e jashtme, pikërisht ndaj atyre që synojnë tabanin, që synojnë thelbin, që synojnë mbrapshtimin e tryezës së besimit dhe adhurimit. Prandaj, shumë prej botimeve të tij do të gesh kritika apo tërheqje vëmendjeje si dhe këshilla për të ruajtur tabanin dhe për të mos devijuar në sektarizma apo çfarë nuk duhet në raport me fenë..."

Duke e përfunduar fjalën e tij, Myftiu i kërkoj të pranishmeve, kryesisht nxënësve të medresesë që të qëndrojnë në besën e të parëve, të shëmbëlltyrës së tyre në dije, në shkollim, në bamirësi dhe në ruajtjen e tabanit shekullor islam, larg devijimeve dhe sekteve përçarëse.

Ndërsa, drejtori i medresesë "Haxhi Sheh Shamia", z. Kujtim Dervishi, pasi falënderoi Myftininë e Shkodrës



për bashkëpunimin dhe organizimin këtij aktiviteti me vlera dhe mesazhe në fjalimin e tij theksoi: "Për aq sa e kam njohur, por edhe takuar fizikisht mendoj se ai është më plotë kuptimin e fjalës dhe të ndjenjës së sinqertë, ai ishte dijetari, mendimtari, veprimtari shoqëror, por edhe atdhetari. E them edhe atdhetari, sepse diku kam lexuar se gjyshi i tij Halil Hoxha, baba i tij, Sulejman Hoxha në kohën e rrethimit të Shkodrës nga serbomalazezët, kanë luftuar, kanë dhanë kontribut të rëndësishëm krah për krah me Hasan Riza Pashën për të mbrojtur territorin dhe vendin e tyre. Pra, nuk janë rastësisht këto familje të mëdha dhe intelektualë e figura të shquara, pra nuk dalin rastësisht. Në mes të tjerave përmendet edhe bamirësia e hoxhës së madh, H. Vehbi Gavoçi, i cili edhe për këtë shkollë ka menduar dhe kontribuar në kohë të ndryshme për mbarëvajtjen e aktivitetit arsimor dhe jo vetëm në këtë vatër të dijes dhe edukatës islame..."

Aktiviteti përkujtimor përfundoi me recitimin e disa fjalëve të ndritura të hoxhës, nga dy medresist, Enis Bajraktari dhe Kadir Braqi si dhe paraqitjen e një ekspozitë të disa librave dhe botimeve të dijetarit, Shejkh H. Vehbi Gavoçi.

Përgatiti: Arben Halluni



H. Vehbi S. Gavoçi
(1923-2013)

“E kisha provuar të vija në Shqipëri në 1974 kur vizitova Kosovën dhe ndenja atje tre muaj, por kur kërkoja të hyja në kufi me Shqipëri nga Prizreni, nuk më lejuan të hyja në vendin tim...por megjithatë unë nuk e mora inat Shqipërinë, pavarësisht se komuniste

Do ta kisha vizituar me shumë ueil Shkodrën, ani pse e dija se komunizmi i kishte shkatërruar xhamitë...

Ne shqiptarët jemi njerëz të mirë, shumë të mirë dhe në Siri kemi ndërtuar gjysmën e Sirisë...

Ne shqiptarët kemi ndërtu shtetet e tjera, po duhet me e ndërtu Shqipërinë mor djema. Shqipëria asht e bukur dhe e ka fal Zotit (xh.sh) me vende të bukura.

Pse me e shkatërru na shqiptarët si në 97'? Jam pikëlluar në 1997 dhe që atëherë s'kam ardh ma në Shqipëri, po du me ardh se jam plak e du me e pa për her të fundit Shqipërinë dhe Shkodrën....



Dr. Mustafa Mahmud

A JANË RITET E HAXHIT IDHUJTARI?

në dituri nuk ka turp!

Pastaj, filloi të nxirrte tymin e cigares me qetësi dhe më vështrohte përmes syzeve të tij.

Me qetësi i thashë:

A nuk e vë re edhe ti me mua gjithashtu, se në ligjet lëndore, të cilat i ke studiuar, se i vogli sillet rreth më të madhit?

Elektroni në atom rrotullohet rreth bërthamës, hëna rrotullohet rreth tokës, toka rreth diellit, dielli rrotullohet rreth galaktikës, galaktika rreth një galaktike më të madhe, derisa të arrijë tek “më i madhi absolut”, e Ai është Allahu! A nuk themi: “Allahu Ekber” (Allahu është më i Madhi), pra më i madh se çdo gjë!

Ti tani po sillesh rreth Tij brenda sistemit tënd diellor, përkundër dëshirës tënde dhe nuk zotëron tjetër, veçse të sillesh rrotull, sepse nuk ka gjë të palëvizshme në univers, përveç Allahut, Ai është “Es-Samed” (i Panevojshëm për askënd), i Palëvizshëm dhe i Qëndrueshëm, ndërsa të gjithë janë në lëvizje përreth Tij.

Ky është ligji i më të voglit dhe më të madhit, të cilin e ke mësuar në fizikë.

Ndërsa ne bëjmë tavaf (rrotullohemi) me vullnetin tonë të lirë rreth Shtëpisë së Allahut (Qabes).

Ajo është shtëpia e parë, që njeriu e ka ndërtuar për adhurimin e Allahut.

Që prej asaj dite të largët, ajo është bërë simbol dhe shtëpi e Allahut.

A nuk silleni rrotull edhe ju rreth një njeriu të balsamosur në Kremlin, e madhëroni dhe thonë, se ai i ka shërbyer njerëzimit? Nëse do ta dini, se ku e ka varrin Shekspiri, do të kishit nxituar se kush do të shkonte i pari për vizitën e varrit të tij, më shumë se sa nxitojmë ne për të vizituar Muhammedin (paqja dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të).

A nuk vendosni buqeta me lule mbi një monument të gurtë dhe thonë, se ai është simbol i ushtarit të panjohur? Atëherë, përse na qortoni, sepse ne hedhim disa gurë mbi një monument simbolik dhe themi, se ai simbolizon shejtanin?

A nuk jeton edhe ti në nxitim (ecje ritmike) nga lindja jote deri në vdekjen tënde? Pastaj, pas vdekjes tënde, djali yt vazhdon nxitimin (ecjen ritmike) rishtas, njësoj si udhëtimi ynë simbolik nga Safaja (Safa: çiltërsia, boshllëku apo zbrazëtia, simbol i mos ekzistencës), tek Mervaja (e ajo është burimi, i cili simbolizon jetën dhe ekzistencën).

Prej mos ekzistencës në ekzistencë, pastaj prej ekzistencës në mos ekzistencë.

A nuk është kjo, lëvizja e lavjerrësit për çdo krijesë!?

A nuk shikon në ritet e Haxhit një përmbledhje simbolike të thellë të gjithë këtyre sekreteve?!

Numri 7, me të cilin ti tallesh! Lërmë mua të të pyes, se cili është sekreti i

shkallëve të notave të muzikës: “Do, Re, Mi, Fa, Sol, La, Si”, pastaj pas ritmit të shtatë, vjen përgjigjja e “So-lit” rishtas. Nuk kemi 8, por kthehemi edhe një herë te shtatë nota të tjera, e kështu me radhë. Kështu është edhe spektri i dritës, 7; kështu edhe elektroni sillet rreth bërthamës në 7 fusha; embrioni nuk plotësohet, përveçse në muajin e 7-të, e nëse lind përpara kësaj, ai vdes. Ditët e javës tek ne janë 7 dhe tek të gjithë individët e racës njerëzore janë 7, të vendosura kështu, pa u ulur dhe pa rënë dakord mes njëri-tjetrit.

A nuk tregon kjo gjë, se ka diçka apo, gjithë këto shkenca, edhe këto janë përralla misterioze?

A nuk pranon mesazh prej të dashurës tënde? A je edhe ti idhujtar? Përse atëherë na qorton nëse ne pranojmë, nëse ne e puthim atë Gur të Zi, të cilin e mbarti i Dërguari ynë, Muhammedi (paqja dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të) me rrobën e tij dhe e puthi? Nuk ka absolutisht asnjë lloj idhujtarie në këtë veprim. Sepse, ne me ritet e Haxhit nuk i drejtohemi vetë këtyre gurëve, por drejtohemi nga kuptimet e thella, simbolikat dhe kujtimet.

Ritet e Haxhit janë disa momente (raste) për të lëvizur mendjen, për të nxitur ndjenjat dhe për të shtuar devotshmërinë në zemër. E, për sa i përket rrobave të ihramit, të cilat i veshim direkt në trup, pa gjë poshtë dhe që është kusht të mos jenë të qepura, ato janë simbolikë e largimit nga zbukurimet e dynjasë dhe zhveshjes së plotë përpara prezencës së Krijuesit.

Pikërisht, ashtu siç vijmë në këtë



ECJA NË SAFA DHE MERVE

botë në një pëlhurë, dalim prej dynjasë në një pëlhurë dhe hyjmë në varr në një pëlhurë.

A nuk e kushtëzoni ju veshjen e kostumit zyrtar për të takuar mbretin, kështu që edhe ne themi: Nuk ka asgjë që i shkon Madhështisë së Allahut, përveçse të zhveshurit dhe heqja e gjithë zbukurimeve, sepse Ai është më i Madh nga të gjithë mbretërit dhe se nuk vlen të qëndroarit përpara Tij, përveçse modestia e plotë dhe “zhveshja”, largimi nga çdo gjë e kësaj bote!

Sepse kjo rrobë e thjeshtë, të cilën e vesh i pasuri, i varfëri, të mëdhenjtë dhe milioneri, përpara Allahut të Madhëruar, ajo ka një kuptim tjetër të vëllazërisë, me gjithë dallimet në grada dhe në pasuri.

Haxhi tek ne është tubim madhështor dhe kongres vjetor. Sikur ai është edhe namazi i xhumasë, ku ai është një kongres i vogël, në të cilin takohemi çdo javë.

E tëra kjo, ka një kuptim të bukur për atë që mendon dhe mediton, porse është tepër larg të qenurit idhujtari.

Sikur të qëndroje së bashku me mua në Arafat, në mesin e disa milionave, që thonë: Allahu Ekber (Allahu është më i Madhi), lexojnë Kur’an në më shumë se njëzet gjuhë, thërrasin “Lebbejkal-llahumme Lebbejk” (Të përgjigjem Ty, o Zot), qajnë dhe shkrihen nga malli dhe dashuria, patjetër do të kishe qarë edhe ti gjithashtu, pa e ditur, sikurse do të treteshe në turmën e pafund të krijesave dhe do të kishe ndërje me këtë venitjen e plotë dhe devotshmërinë përpara Zotit të Madh, Zotëruesit të gjithësisë, në dorën e të Cilit janë çelësat e çdo gjëje.

Marrë nga libri:
DIALOG ME MIKUN TIM ATEIST

Përktheu nga arabishtja
dhe përshtati në shqip:

Lavdrim Hamja



TAFIVI DHE NAMAZI NË QABE



MALI I ARAFATIT

GUINEA-BISSAU OSE REPUBLIKA E GUINEA-BISSAUT

Guinea-Bissau, ose zyrtarisht: 'Republika e Guinea-Bissaut', është një vend i vogël që gjendet në Afrikën Perëndimore, në bregdetin e Atlantikut.

Guinea-Bissau kufizohet nga Senegali në veri, Guinea në lindje dhe jug dhe nga oqeani Atlantik në perëndim. Dikur, gjatë pushtimit portugez, ky vend quhej Guinea Portugeze, por pas pavarësisë, emri i kryeqytetit 'Bissau' iu shtua emrit 'Guinea', për të mos u ngatërruar me Republikën e Guinesë, fqinja e saj në lindje dhe në jug.

Guinea-Bissau ka një sipërfaqe prej 36.125 km² dhe një popullsi prej 2.046.526 banorësh (shkurt 2022, sipas worldometers.info).

Kryeqyteti i vendit është **Bissau**.

Pothuajse e gjithë Guinea-Bissau është një territor i ulët dhe laget çdo ditë nga ujërat e baticës që arrijnë deri në 100 km në brendësi të tokës. Në pjesën juglindore të vendit, pllaja Fuuta Xhaaluun ngrihet afërsisht në 180 metra mbi nivelin e detit. Kodrat Boé shtrihen nga shpatet perëndimore të Fuuta Xhaaluun, deri në pellgun Corubal, dhe në rrafshnaltën Gabú.

KLIMA

Guinea-Bissau ka një klimë përgjithësisht tropikale dhe karakterizohet nga dy stinë të theksuara: stina e nxehtë me shi, e cila zakonisht zgjat nga qershori deri në nëntor, dhe stina e ftohtë dhe e thatë. Prilli dhe maji janë muajt më të nxehtë atje. Temperatura mesatare në vend është rreth 30 °C. Në Guinea-Bissau reshjet nuk ndryshojnë shumë sipas lartësisë, por ndryshimi ndodh mes zonave bregdetare dhe atyre të brendshme. Bregdeti merr rreth 1.500 deri në 3.000 mm reshje, ndërsa pjesa e brendshme ndikohet nga klima tropikale e savanës, me ndryshim më të madh të reshjeve dhe temperaturës.

GJUHA

Mes gjuhëve të shumta afrikane që fliten në Guinea-Bissau, janë rreth 20 gjuhë dhe dialekte (të klasifikuara në degët Atlantike dhe Mande të gjuhëve Niger-Kongo) ato që mbizotërojnë. Edhe pse portugalishtja është gjuha zyrtare në vend, gjuha Kreole (një gjuhë e përzier mes portugalishtes dhe gjuhës së vendasve, që u shfaq gjatë tregtisë

së skllëvërve) është jo që flitet si 'lingua franca', dhe që ka një influencë unifikuese në zonat rurale.

FEJA

Islami në Guinea-Bissau është feja dominuese në vend, e përqafuar nga 50% e banorëve të saj, dhe shumica e tyre janë myslimanë sunitë; 18.9% e popullsisë janë të krishterë, kurse pjesa e mbetur u përkasin besimeve pagane.

pulpa e palmës, përfaqësojnë mallrat kryesore të eksportit të Guinea-Bissau. Kurse, sa u përket mallrave të importit, në krye të listës qëndrojnë karburantet dhe tekstilet e pambukut. Portugalia është partneri kryesor tregtar i Guinea-Bissau.

HISTORI

Historia parakoloniale e Guinea-Bissau nuk është dokumentuar plotësisht



EKONOMIA

Burimet bujqësore dhe minerale, dhe potenciali industrial i Guinea-Bissau, mbeten akoma të pashfrytëzuara. Më shumë se 50% e fuqisë punëtore totale në vend merret me bujqësi. Kulturat kryesore bujqësore përfshijnë: fasulet, arrën e kokosit, kokrrat e palmës, misrin, kikirikët dhe orizin.

Sektori industrial thith një përqindje të vogël të fuqisë punëtore totale në këtë vend. Sektori i ndërtimit dhe i industrisë ushqimore janë sektorët që thithin më shumë fuqi punëtore. Kikirikët, arrat shqeme, karkalecat e detit, kokosi dhe

në të dhënat arkeologjike.

Popullsia Fulani hynë në rajon si barinj gjysmë nomade, qysh në shekullin e 12-të, megjithëse vetëm në shekullin e 15-të ata filluan të mbërrinin në numër të madh. Në shekullin e 13-të, një pjesë e banorëve të kësaj zone filluan të afroreshin më pranë bregut, ndërsa të tjerët u përzier me popullsinë Mande, pasi që perandoria Mali i zgjeroi kufijtë e saj deri në këtë zonë.

Kontaktet e kësaj zonë me Evropën filluan me eksploruesit dhe tregtarët portugezë, që mbërritën atje në gjysmën e parë të shekullit të 15-të. Portugezët e

monopolizuan eksplorimin dhe tregtinë përgjatë bregut të Guinesë së Epërme, që nga fundi i shekullit të 15-të, dhe nga fillimi i shekullit të 16-të, derisa edhe francezët, spanjollët dhe anglezët filluan të konkurronin për pasurinë e Afrikës.

Dhjetëra mijëra guineanë u morën dhe u dërguan si skllëvër në Kepin Verde, për të punuar në plantacionet e pambukut, të bimëve të orkelës (që përdorshin për prodhimin e ngjyruësve), dhe për ruajtjen e bagëtive.

Në fund të shekullit të 18-të dhe në fillim të shekullit të 19-të, pati një iniciativë të Anglisë dhe të Shteteve të Bashkuara për të shfuqizuar ose ngadalësuar tregtinë e skllëvërve. Megjithatë, boshllëqet ligjore dhe indiferenca politike e minuan këtë program.

Në vitin 1879, administrimi i përbashkët afatgjatë i Kepit Verde dhe Guinea-Bissau, u ndërpre, dhe të dyja këto u bënë territore të veçanta koloniale: Kapi Verde dhe Guinea Portugeze. Megjithatë, rivalitetet evropiane për kontrollin e rajonit vetëm u intensifikuan. Lufta për dominim në rrethinat e Guinea-Bissau karakterizoi përleshjen më të madhe të bërë për Afrikën në Kongresin e Berlinit, në 1884–85. Kongresi i Berlinit kishte bërë thirrje për demonstrimin e një "pushtimi efektiv", dhe në përpjekje për të përmbyshur këtë kusht, kishte nisur fushata brutale e "pacificimit", e komanduar nga João Teixeira Pinto (i mbështetur nga një forcë mercenare afrikane), fushatë e cila zgjati nga viti 1913 deri në vitin 1915. Vrasjet dhe masat e ashpra ndëshkuese të marra nga portugezët dhe mercenarët e tyre për shtypjen e popullsisë, sollën një protestë të gjerë popullore.

Gjatë Luftës së Dytë Botërore, shumë afrikanë fituan përvojë ushtarake dhe politike duke luftuar për fuqitë koloniale. Në vazhden e asaj lufte, erdhi shfaqja e lëvizjeve nacionaliste afrikane, dhe nga fillimi i viteve 1960, shumica e vendeve të Afrikës Perëndimore kishin arritur pavarësinë përmes protestave, peticioneve, demonstratave dhe mënyrave të tjera kryesisht paqësore.

Në vitin 1956, në Kepin Verde u themelua Partia Afrikane për Pavarësinë e Guinesë dhe të Kepit Verde (Partido Africano da Independência da Guiné e Cabo Verde - PAIGC). Më i shquari ndër udhëheqësit e kësaj partie ishte Amílcar Cabral, një teoricien i shkëlqyer revolucionar. Në fillim, këta kërkonin të arrinin pavarësinë përmes protestave



KRYEQYTETI, BISSAU

paqësore. Por, në Gusht të vitit 1959, portugezët iu përgjigjën me dhunë një greve të punonjësve të portit, duke vrarë dhe plagosur demonstrues të shumtë, gjë që e bindi PAIGC se vetëm një luftë e armatosur do të mund t'i jepte fund regjimit kolonial dhe fashist në vend. Pas një periudhe trajnimit ushtarak dhe përgatitjeje politike, në janar të vitit 1963, PAIGC filloi fushatën e saj të armatosur. Me krijimin e Forcave të Armatosura Revolucionare Popullore (Forças Armadas Revolucionarias do Povo) dhe Forcave të Armatosura Lokale (Forças Armadas Locais), u parashikuan veprime ushtarake sulmuese dhe mbrojtëse.

Pavarësisht se u përball me një numër të madh ushtarësh portugez dhe me teknologjinë ushtarake shoqëruese të tyre, PAIGC fitoi kontrollin e rreth dy të tretave të vendit. Më 20 janar 1973, Cabral u vra, megjithatë, më 24 shtator të vitit 1973, u shpall pavarësia e vendit. Por, pavarësia e plotë në Guinea-Bissau u arrit më 10 shtator të vitit 1974, dhe Luís de Almeida Cabral u zgjodh presidenti i parë i Guinea-Bissau.

SI ERDHI ISLAMI NË GUINEA-BISSAU

Merita e madhe për përhapjen e Islamit në rajonin e Guinea-Bissau i takon popullsisë Fulani. Ata banonin në Afrikën Perëndimore dhe themeluan një mbretëri të madhe në shekullin e 14-të (e.j.), mbretëri e cila shtrihej nga lumi Gambia e deri në brigjet e Atlantikut. Fulanët arritën të merrnin nën kontroll Mbretërinë Mandi, dhe meqenëse ishin ndjekës të Almoravidëve, punuan fort për përhapjen e Islamit në rajonin që përfshinte atë që sot është shteti i Guinea-Bissau.

Në vitet e fundit, shumë banorë të Guinea-Bissau e kanë përqafuar Islamin në masë të madhe. Statistikat tregojnë një rritje të konsiderueshme

të konvertimit në Islam. Kjo falë përpjekjeve të disa organizata bamirëse islame, të cilat i shërbejnë thirrjes Islame, përhapjes së arsimit dhe të humanizmit atje. Ata kanë bërë përpjekje për ta njohur popullatën e atij rajoni me Islamin, për korrigjimin e koncepteve themelore të të konvertuarve të rinj, për konfirmimin e tyre në Islam, si edhe për të krijuar një klimë të re në të cilën këta të konvertuar të përshtaten me mjedisin e ri, modelin dhe sistemin e jetës që e përcakton Islami. Vërehet një prirje e madhe për të përqafuar Islamin nga të gjitha shtresat e ndryshme të shoqërisë në Guinea-Bissau, si në qytete, edhe në fshatra.

Ajo që i nxiti njerëzit e Guinea-Bissau të hyjnë në Islam, janë përpjekjet e vazhdueshme të bëra nga disa institucione për Thirrjen Isame, por edhe kontaktet e individëve me muslimanët e përkushtuar dhe admirimi i sjelljes së tyre.

Fise që më parë ishin larg Islamit për shkak të lidhjes së tyre me paganizmin nga njëra anë dhe krishterimin nga ana tjetër, filluan ta pranojnë Islamin në masë të madhe kohët e fundit, të tillë si fisi Balanta, i cili përfaqëson më shumë se 40% të popullsisë së vendit.

Vitet e fundit, vendi ka qenë dëshmitar i konvertimit në Islam edhe i liderëve të mëdhenj të politikës, përfshirë ish-presidentin Kumba Lala, një anëtar i fisit Balanta, i cili pas konvertimit në Islam e ndryshoi emrin e tij në Mohamed Ialá Embaló.

Përgatiti:

Msc. Arta Ujkaj, teologe

<https://www.worldometers.info>
<https://islamonline.net>
<https://en.wikipedia.org>
<https://ar.wikipedia.org>
<https://www.britannica.com>
<https://www.marefa.org>

PËRURIMI I QENDRËS KULTURORE, "ÇELËSAT E TË MIRËS" BARBULLUSH



PROJEKTI “VETJA” – NJË INVESTIM DOBIPRURËS

Në këtë shkrim do të flasim për projektin “vetja”, si një projekt për një investim afatgjatë, ku frytet e tij i marrim sot, por edhe përtej së sotmes, në Ahiret.

Së pari, çfarë kuptimi ka fjala projekt?

Në fjalorin e gjuhës shqipe, projekt do të thotë: “Plani i një pune për të ardhmen, ide a mendim që kemi për diçka.”¹ Por, për realizimin e çdo projekti duhen ndjekur disa etapa, me qëllim përmbushjen e tij. Këtu do të përmendim etapat e përmbushjes së tij, duke e paralelizuar me elementët brenda vetes tonë:

ETAPAT E PROJEKTTIT “VETJA”

Idea fillestare: Fillon me ndërgjegjësimin rreth qëllimit të ekzistencës dhe nevojës për përmirësim.

Skica: Mbart rëndësinë e vendosjes së hapit të parë, e cila fillon me fjalën e parë të Kuranit, ‘Lexo!’

Sipërmarrja: Mbështetet në shqyrtimin e argumenteve të Zotit në Kuran dhe traditën profetike.

Investimi: Është kërkimi i dijes në mënyrë të vazhdueshme dhe këshillimi me njerëzit e ditur dhe besimtarët.

Përditësimi: Është fillimi i zbatimit në jetë të cilësive të një muslimani pak nga pak.

Marrja e frytit: Ndryshimi i tërësisë së mendimit, komunikimit, sjelljes dhe gjendjes tënde në këtë botë, duke u bazuar në besimin e plotë në Zot. Por edhe me shpresën e shpërblimit në jetën e përtejme. Allahu xh.sh thotë: “Vërtet, kushdo që e pastron shpirtin, do të shpëtojë. Ndërsa kushdo që e shtyp atë (me punë të këqija), do të dështojë.”²

Nëse ndalemi pak, do vëmë re, se çdo investim që bëhet në anën materiale vlen vetëm për këtë botë, ndërsa investimi për “veten” zgjat në dy botët. Gjithashtu individit në të njëjtën kohë, bëhet model për familjen e tij, por edhe për njerëzit e tjerë.

Duhet të kemi parasysh se Zoti i Plotfuqishëm e ka krijuar njeriun dhe e ka pajisur atë me përcëptorë të ndryshëm në mënyrë, që njeriu të mbijetojë në këtë botë dhe të arrijë lumturinë e tij në botën tjetër. Ndër këto përcëptorë, që i ofrohen atij është edhe ai, që Kur’ani i referohet me fjalën: nefsi, vete, shpirt. Kur Allahu

i Lartësuar thotë: “...po edhe në vetët tuaja – a nuk e shihni vallë?”³, në realitet Ai kërkon prej nesh, që të shikojmë brenda vetes, që të mos jemi nën drejtimin e ndikimit të çfarëdoshëm, por të kuptojmë përsosmërinë dhe vlerën tonë të vërtetë, e cila bëhet udhëheqje e vetëve tona. Sepse “vetja” si shpirt është e karakterizuar nga dy pjesë të rëndësishme, nga përgjegjësia dhe vullneti i lirë.

Fjala që lidhet më së miri me “veten” dhe me kuptimin më të thellë të saj, kërkon lidhje të pandashme me vetëdijen. Ky qëllim i krijimit nuk realizohet as në vetë izolim, as në shkapërderdhje. Nga vetë përbërja e fjalës “vetëdije”, ne mund të marrim mesazhin e madh: *vetëdije = vete + dije*.

- Dija e parë, i jep thelbin vetes, e cila është njohja e Zotit, pra besimi tek Ai.

- Dija e dytë, pason edhe rrugëtimin e të parës, e cila është përmbushja e vetes nga ana kuptimore, funksionale në dimensionin më të thellë, që është edhe analiza e vetes.

Qëllimi i këtij shkrimi përkon pikërisht me transmetimin e kësaj dije, për “veten” tonë, duke filluar me secilin lexues, ku me ndihmën e Zotit e vendosim në praktikë, duke e bërë pjesë të pandashme të rrugëtimin tonë.

Allahu na ka dhuruar forcën e mendjes njerëzore, që të hulumtojmë, analizojmë, dëshmojmë dhe të kemi forcën e zbulimit, me qëllim që të besojmë sa më shumë te Ai. E këtë besim ta vëmë në praktikë, në mënyrë që të realizojmë përmbushjen e shpirtit, pra të vetes.

Vetja e njeriut karakterizohet nga elasticiteti dhe aftësia për tu përshtatur në mjedisin ku ndodhet, në mënyrë që të arrijë gjendjen e ekuilibrit, në përshtatshmëri me interesat që i pulsojnë, si nga brenda vetes (siç janë kënaqësitë, dëshirat, etj) por edhe nga jashtë saj (siç është shoqëria dhe nevoja për përkatësi). Shpesh këto dy forca mund të jenë kontradiktore, nëse kërkesat e shoqërisë nuk janë në përshtatje me boshtin e vlerave të përcaktuara nga Zoti i Gjithëdijshëm. Tek ky bosht duhet të rikthehemi herë pas here për tu siguruar, se puna mbi “veten” po realizohet në sfondin e përcaktuar, dhe më pas duhet të vëzhgohet nëse po merr formën e duhur.

Shumë herë, me qëllimin e zbulimit të forcës së vërtetë, ne e hulumtojmë anën tonë të brendshme përmes opinionëve, ndjesive dhe kuptime negative, me të cilat përcaktohet e kaluara e botës së jashtme. Fillimi i këtij kuptimi nis prej vendosjes së marrëdhënies tonë me prindërit, më pas me rrethin familjar, shoqëror, arsimor, etj. Pra një përqindje e madhe e vlerave tona emocionale janë arritur prej asaj që ka transmetuar në mënyrë automatike bota e jashtme. Ky proces ndodhë në fazat e hershme të formimit tonë, kur akoma nuk jemi të formuar intelektualisht. E ajo që përftohet nga ky proces është produkt i servitur nga të rriturit, kujdestarët, prindërit dhe kushdo që është përgjegjës në edukimin e individit e të brezave. Kjo do të thotë se n.q.s. gjatë gjithë kohës njeriut i jepet çdo gjë e gatshme dhe nuk i krijohet hapësira për të reflektuar, ai në mënyrë instiktive e graduale do të minimizojë mundësinë për të ndërtuar forcën e mendimit personal, por edhe aspektin kritik apo analizues.

DUHET TË KEMI PARASYSH SE ZOTI I PLOTFUQISHËM E KA KRIJUAR NJERIUN DHE E KA PAJISUR ATË ME PËRCËPTORË TË NDRYSHËM NË MËNYRË, QË NJERIU TË MBIJETOJË NË KËTË BOTË DHE TË ARRIJË LUMTURINË E TIJ NË BOTËN TJETËR. NDËR KËTO PËRCËPTORË, QË I OFROHEN ATIJ ËSHTË EDHE AI, QË KUR’ANI I REFEROHET ME FJALËN: NEFSI, VETE, SHPIRT.

Pas pranimit të faktit se mosvënia në përdorim, ose moskonsiderata e nefsit mund ta çojë njeriun në humbje dhe mund të bëhet kërcënim për jetën e tij të përtejshme, kërkohet një rëndësi e veçantë, jo vetëm të kuptuarit e anës negative, por dhe të kuptuarit se si punon nefsi jonë. Normal që kjo nuk është një arritje e lehtë, për shkak se kërkohet që njeriu të aktivizojë “veten” e brendshme dhe jo thjesht fizikun e tij, duke u përballur herë pas here me ndikimin, që shoqëria jashtë ndërhyr në “vetët” tona. Me fjalë të tjera, kjo është një luftë shpirtërore dhe jo materiale.

Shpesh, njerëzit tregojnë vëmendje të veçantë në parandalimin e sëmundjeve të trupit, por neglizhojnë në parandalimin e sëmundjeve shpirtërore dhe bëhen

viktima të ambicieve të tyre ose të rrjedhës shoqërore. Prandaj, na lind nevoja të ndalemi dhe të shqyrtojmë rëndësinë e identifikimit të vetes me nevojat nefsit/shpirtit.

Kuptimin e thellësive të vetes do ta trajtojmë në tre fusha: Vetë-përpjekje / Vetë respekt / Vetë – neglizhencë.

VETË-PËRPEKJA

Fjala përpjekje do të thotë, një ose më shumë veprime mendore ose fizike të organizuara e të orientuara drejt qëllimit, për të arritur një gjendje të përmirësuar.

Pra, vetë - përpjekja është organizimi dhe orientimi i aftësive mendore dhe fizike drejt një qëllimi të paracaktuar, për të arritur një gjendje të përmirësuar të vetes tonë.

Përfitimet e arritura nga kjo përpjekje, janë të lidhura drejtpërdrejt me parimin tonë për të mirën (të dobishmen), e të keqen (kotësinë).

Elementet me të cilat ndërtohet struktura e vetë-përpjekjes janë: përmirësimi i mënyrës se si ne mendojmë, flasim, sillemi, ndërtojmë marrëdhënien me njerëzit, me diturinë, etj. Të gjitha këto nëse pasohen me

Shpesh, njerëzit tregojnë vëmendje të veçantë në parandalimin e sëmundjeve të trupit, por neglizhojnë në parandalimin e sëmundjeve shpirtërore dhe bëhen viktima të ambicieve të tyre ose të rrjedhës shoqërore. Prandaj, na lind nevoja të ndalemi dhe të shqyrtojmë rëndësinë e identifikimit të vetes me nevojat nefsit/shpirtit.

boshtin e vlerave islame, bëhen pjesë e pandashme e falënderimit ndaj Zotit.

Vetë-përpjekja, së pari, fillon me përmirësimin e vazhdueshëm të vetes, jo për shkak të pakënaqësisë për “veten”, por nga dëshira e brendshme për të kënaqur Allahun, dhe që të arrijmë të jemi më mirë se dje.

Së dyti, nuk është kusht që qëllimet tona të jenë të mëdha e pompoze, por mjafton edhe një marrëveshje mes vetes dhe Zotit, që atë punë do ta bëjmë për hatër të Tij.

Ky përmirësim vlen për secilin nga ne, por automatikisht lë gjurmë edhe tek të tjerët që kemi përreth.

VETË-RESPEKTI

Fjala respekt do të thotë, një ndjenjë

e thellë admirimi për dikë a diçka e shkaktuar nga aftësitë, cilësitë ose arritjet e atij personi.

Vetë-respekti është vlerësimi subjektiv i një individi për “veten” e tij, duke përfshirë besimet për “veten”, gjendjet emocionale të tij (si krenari, dëshpërim, turp, sukses, etj.)

Rogers besonte se të gjithë njerëzit kanë nevojë për vetëvlerësim pozitiv, si një rrugë drejt mirëqenies psikologjike. Në mungesë të një vetëvlerësimi të tillë, nevoja e individit për një pikëpamje pozitive për “veten”, mund të jetë e paplotësuar, duke çuar në shqetësime psikologjike.

Një shkak për prishjen e balancës së vetëvlerësimit është tendenca krahasuese, p.sh. Po sa mirë ai/ajo... e pse jo unë... Në këto kushte, na lind nevoja të rikujtojmë, që secili prej nesh është unik në vetvete, pra ka individualitetin e tij. Ajo që na del në pah është rëndësia e meditimt ose thellimit të vetes duke vlerësuar atë, që është e ndryshme tek ne, për ti dhënë jetë asaj dhe duke konsideruar gjithmonë, boshtin moral dhe etik si referencë vendimtare. Prandaj zilia në fenë Islame dënohet dhe konsiderohet e rrezikshme për individin, por lejohet vetëm zilia pozitive, e cila ka për qëllim arritjen e statusit të dikujt, pa ia pakësuar mirësitë atij/asaj, as sa fija e flokut. Për këtë Profeti (a.s) ka thënë: “Vetëm dy persona mund të kihen zili. Njëri është ai person të cilit Allahu i ka dhënë pasuri dhe ai e shpenzon në rrugën e Tij. Ndërsa tjetri, është ai person të cilit Allahu i ka dhënë dituri dhe ai, përveç se punon me të, ua mëson edhe të tjerëve.”⁴

VETË-NEGLIZHENCA

Fjala neglizhencë do të thotë, lënia pas dore, ose një lloj harresë {afatshkurtër apo afatgjatë} e një koncepti, sjelljeje, sendi, individi, etj.

Vetë-neglizhenca është një përkushtim ndaj nevojave e dëshirave materiale dhe lënia pas dore (harresa) e çështjeve shpirtërore (dhe burimeve të saj).

Vetë-neglizhimi nuk përshkruhet drejtpërdrejt nga psikologët, por shoqërohet me kuptimin e materializmit të përcaktuar në fjalorin anglisht të Oksfordit “përkushtimi ndaj nevojave ose dëshirave materiale, neglizhenca ndaj çështjeve shpirtërore; një mënyrë jetese, opinioni ose prirje e bazuar tërësisht në interesa materiale.” Tradicionalisht, vetë-neglizhimi, si koncept dhe kusht,

është në kontrast me shpirtëroren e anasjelltas⁵ dhe gjithashtu harresa e normave të kujdesit për shpirtin, mund të shoqërohet me kryerjen e mëkatit⁶.

Për natyrë njeriu është krijuar për të arritur plotësimin e vetes, realizimin dhe përmbushjen e saj. Në sfondin e neglizhencës zhvillohet një rreth vicioz, që është kërkimi i kënaqësisë përmes përvetësimit të sendeve me x vlerë, përtej nevojave thelbësore që i duhet një individi për realizimin e nevojave jetësore, -> zhgënjimi, i cili vjen me përjetimin e përkohshëm të kënaqësisë që vjen nga materia-> zbrazja, e cila është gjendja e përfutur pas mbarimit të efektit.

Rregulli i kësaj bote është ndërveprimi me gjëra të fundme, përveç atyre që Zoti ka premtuar se zgjasin edhe pas vdekjes së njeriut, që janë shpirti dhe puna e mirë.

Në fushën e këshillimit psikologjik vetë-neglizhimi interpretohet, thjesht si produkt i reagimit mbrojtës⁷. Me këtë kuptojmë se individi, duke dashur të shmanget nga mundësia e humbjes apo dështimit, e cila sërvi përjetime emocionale negative, lëndime, preferon “dorëheqjen” nga çdo lloj iniciative mbi “veten”. Nga ana tjetër, sjellja e ekuilibruar krijon njëfarë efekti progresiv tek vetja, nëse theksohet nevoja për të dyja investimet, si shpirtërore ashtu edhe materiale.

PROCESET E INVESTIMIT NË VETE

Lind pyetja, si mund të investojmë ne “veten” tonë, me një investim dobiprurës dhe afatgjatë? Për këtë kemi zgjedhur disa këshilla, të cilat janë shumë të rëndësishme për investimin në veten/shpirtin e secilit prej nesh.

a. Llogaritja e vetvetes (muḥāsebeh) apo vetë-refleksioni

Ta llogarisësh ose ta analizosh “veten” tënde (muḥāsabah) është një ndër veprat më të theksuara në Islam. Udhëheqësi i besimtarëve Omer bin Hattabi ka thënë: “Bëni llogari vetes tuaj, para se të merreni në llogari”⁸

Kalimi i ditëve dhe i netëve, njeriun e mençur, veçanërisht muslimanin, e shtyn të ulet me vetveten dhe t’i kërkojë llogari asaj për atë që ka bërë. Kështu ai i merr në konsideratë gjynahet, pendohet tek Zoti dhe i rishikon punët e tij. Nëse janë të mira i shton e nëse janë të urryera

- Case, 1997.
- Andreason, 1972.
- Şimşek, 2005.
- Transmetuar nga Ibn Ebi Dunja dhe Imam Ahmedî.

mundohet t'i japë fund dhe të largohet prej tyre. Kështu që besimtari do të vazhdojë të jetë në mirësi, përderisa ka një ndjenjë të brendshme që e drejton.

Allahu i Madhëruar në Kur'anin Fisnik na këshillon duke thënë: “O besimtarë, frikësojuni Allahut dhe çdo njeri le të shikojë se ç'ka përgatitur për të nesërmen! Kijeni frikë Allahun, sepse Ai di çdo gjë që bëni ju! Mos u bëni si ata që e harruan Allahun, kështu që Ai i bëri të harronin vetveten!”⁹

Shumica e njerëzve gjykojnë mangësitë e të tjerëve dhe harrojnë për të gjykuar veprimet e tyre. Duke eksploruar të metat e njerëzve të tjerë dhe duke injoruar të metat tona, asnjëherë nuk mund të përmirësohemi. Mos vallë, kemi mbaruar punë me të metat tona, prandaj i vërsulemi dhe i përvishemi të metave të të tjerëve? Mos vallë kemi kaq kohë të lirë, sa që të angazhohemi me gabimet e njerëzve të tjerë?

Referuar ajetit në fillim të shkrimit, njeriu në fillim është përgjegjës i shpirtit të vet e të thellimit në “veten” e tij. Jo vetëm aq, por ne jemi gjithashtu të rekomanduar, që njerëzit e urtë të na këshillojnë, sepse individit është i kufizuar në perceptimin e të gjitha të metave, ndërsa të tjerët mund të shikojnë dhe t'i vërejnë ato më shumë, duke vëzhguar sjelljen tonë të jashtme. Për këtë, Ebu Bekri, sapo mori detyrën e halifes, deklaroi: “Unë nuk jam më i miri midis jush. Nëse bëj mirë, më ndihmoni dhe nëse anoj drejt së keqe, atëherë më drejtoni në rrugën e drejtë.”¹⁰

b- Kërkesa e ndihmës nga Zoti

Një mënyrë tjetër që mund të jetë e dobishme në përmirësimin dhe investimin në vete (nefsin e njeriut) nga ambiciet është kërkesa e ndihmës së Zotit në luftën kundër epsheve. Kjo lutje tregon se jo vetëm kërkojmë ndihmën dhe suksesin nga Allahu, por edhe se fuqinë tonë ia atribuojmë Atij dhe largohemi nga krenaria e mendjemadhësia. Në suren Näs, Allahu e urdhëron Profetin Muhammed (a.s) dhe ne si besimtarë, që të kërkojmë strehimin (mbrojtjen) tek Zoti i njerëzimit, duke thënë: “Thuaj: “Kërkoj mbështetje te Zoti i njerëzve.”¹¹

c- Qëndrimi në shoqërinë e njerëzve të mirë

Duhet të mundohemi që të shoqërohemi me njerëz të mirë, por kjo nuk nënkupton të qëndrosh në kafe gjithë

ditën me një njeri besimtarë, sepse e humbet qëllimin. Prandaj këto shkrime të koncepteve, qoftë trajtime e ligjërata, janë me qëllimin e angazhimit dhe të përkujtesës së njëri-tjetrit, sepse rruga e cila nuk e humbet njeriun është dija. Dhe ku ka më mirë, që shtimin e dijes dhe përmirësimin e investimin në “veten” tonë, ta arrijmë me anë të shoqërisë së mirë.

Por, duhet pasur parasysh një gjë të rëndësishme, se shoqërimi me njerëzit e mirë kërkon durim dhe këmbëngulje nga ne, sepse nefsi ynë mërzitet dhe e ka të vështirë të qëndrojë me ata që e përkujtojnë Allahun dhe e këshillojnë nefsin, ndërkohë që nefsi i pëlqen më tepër të qëndrojë e të shoqërohet me njerëz që jepen pas kënaqësive dhe e harxhojnë kohën e tyre në dëfrime.

Rumi thotë: “Përpjekjet me nefsin janë të llojeve të ndryshme, por më e madhja dhe më e vështira është përpjekja e qëndrimit të vazhdueshëm me ata që i kanë drejtuar fytyrat e tyre nga Zoti dhe i kanë kthyer shpinën kësaj bote.”¹²

d- Mos shtyrja (e punëve të mira) për më vonë

Një nga problemet me të cilin njerëzit ballafaqohen shpeshherë, është dhe caktimi i një dite në të ardhmen, në të cilën personi vendos të heqë dorë nga një mëkat. P.sh. do ta lë këtë punë të keqe, me datën kaq... apo do ta bëj këtë punë të mirë vitin tjetër, p.sh. dua të mësoj ta lexoj Kuranin me shkronja arabe, e filloj vitin tjetër, etj... E vërteta është se askush nuk mund të garantojë të ardhmen, e cila është pjesë e dijes së Zotit, e nuk e di a do të jetojë deri në atë kohë. Prandaj ne duhet ta korrigjojmë menjëherë “veten” tonë, e t'i vëmë në zbatim, në jetë sa më shpejt punët e mira, duke mos i shtyrë për më vonë.

Ndonjëherë ndodhë, që të presim të tjerët të na ndryshojnë. Kjo jo vetëm që tregon dobësinë tonë, por dhe një kuptim të gabuar në lidhje me trajtimin e nefsit. Zoti i Plotfuqishëm thotë në Kur'an: “..Me të vërtetë, Allahu nuk e ndryshon gjendjen e një populli, derisa ata të ndryshojnë ç'kanë në vetvete...”¹³. Prandaj duhet të mundohemi të ndryshojmë për mirë veten tonë dhe të fillojmë sa më parë, pa e shtyrë për më vonë, sepse ambiciet në këtë botë i ngajnë iluzioneve, të cilat janë tërheqëse nga jashtë, por bosh nga brenda.

Gjithashtu, duhet pasur parasysh

se përpjekja për “veten” është e lidhur ngushtë edhe me njerëzit e tjerë, pra me shoqërinë. Kështu që, nëse besojmë te investimi i vetes dhe përpjekja të përmirësojmë besimin tonë, pa diskutim kemi kontribuar edhe në ndërtimin e shoqërisë dhe në jetësimin e vlerave morale islame, sepse një e mirë personale bëhet një e mirë kolektive.

SHUMICA E NJERËZVE GJYKOJNË MANGËSITË E TË TJERËVE DHE HARROJNË PËR TË GJYKUAR VEPRIMET E TYRE. DUKE EKSPLORUAR TË METAT E NJERËZVE TË TJERË DHE DUKE INJORUAR TË METAT TONA, ASNJËHERË NUK MUND TË PËRMIRËSOHEMI. MOS VALLË, KEMI MBARUAR PUNË ME TË METAT TONA, PRANDAJ I VËRSULEMI DHE I PËRVISHEMI TË METAVE TË TË TJERËVE?

Prandaj le të investojmë në “veten” tonë duke lexuar sa më shumë, duke mos qëndruar kot, duke mos qëndruar në pasivitet, por ta nisim që nga muhasebeja (kërkimi llogari i vetes), kërkimi i ndihmës nga Zoti, qëndrimi me njerëzit e mirë dhe bërja e punëve të mira në atë çast pa i shtyrë më vonë. E kështu do arrijmë të bëjmë diçka për “veten”, por njëkohësisht do jemi shembull për fëmijët tanë e për shoqërinë!

Le të tregojmë kujdes më tepër, sepse truri jonë (për nga funksioni e natyrshmëria e krijimit) nuk e percepton pasivitetin dhe boshllëkun, kështu që ai automatikisht, do të mbushet me informacione të padobishme, të cilat do i perceptojë gjatë kohës kur vetja ndërvepron në mjedis, si në mënyrë aktive apo edhe pasive me nivelin e ndërgjegjes. E sa më shumë të jemi prezent me “veten”, aq më shumë kemi për të arritur dobi dhe punë të mira. Njëkohësisht do të zhvillojmë trurin tonë, por edhe do të shtojmë besimin tonë, pasi çdo dije na afron me Krijuesin, të Gjithëdijshmin.

E lusim Allahun e Madhëruar të na ndihmojë në përpjekjet tona ndaj ambicieve dhe nefsit. E lusim të na bëjë të mundur vlerësimin e faktit që jemi besimtarë muslimanë, e që çdo investim dhe punë të mirë, që bëjmë për të përmirësuar vetën tonë, t'ia marrim frytet në këtë botë, por edhe në Ahiret!

MSc. **Zamira Bushati** (Puka)

Vaize - Myftinia Shkodër

MSc. **Admira Guri**, Psikologe

NAMAZI I NATËS, SHËRIM PËR TRUPIN, PARANDALUES I SËMUNDJEVE KRONIKE DHE STIMULUES PËR ZEMRËN E SHPIRTIN

Namazi i natës është shërimi më efektiv për të trupin, parandalimi më i mirë i sëmundjeve kronike

Namazi i natës ... A e di te se ç'është namazi i natës? Ajo është praktikë e pashmangshme e Pejgamberit (a.s), e njerëzve të mëdhenj dhe të zgjedhur. Ajo është shkollë nga dolën më të mirët e gjeneratave të para dhe të vonshme. Sikur vlera e saj të ishte e vetme që Pejgamberin (a.s), e ka ngritur në vendin e nderit (“el-mekamul-mahmud”, do t'i mjaftonte si vlerë dhe nderë.

Allahu thotë: “Dhe në një pjesë të natës zgjohu me të (me Kur'anin - namazin), është e sigurt se Zoti yt do të ngrejë ty në një vend të lavdishëm..”. - (El-Isra, 79)

Njerëzit e devotshëm e kanë ditur se namazi i natës, është shkollë e te sinqertëve dhe karvani i më të mirëve, se Allahu i ndan dhuratat dhe thesaret e mirësisë së Tij në thellësinë e natës për ata që gjumin e zëvendësojnë me të qëndruarit zgjuar, ndërsa i privon të shkujdesurit dhe gjumashët. Robi nuk mund t'i arrijë shkallët e larta e as Allahu nuk do t'ia ndriçojë zemrën me urtësi nëse nuk merr pjesë në namazin e natës.

Sekreti i madhështisë se namazit të natës është se duke u zgjuar dhe duke e lënë krevatin, njeriu lë kënaqësinë, rehatinë, komoditetin e kësaj bote për t'iu dorëzuar ibadetit dhe Allahu, si kompensim, i jep më shumë se ajo që ka lënë.

Shpërblimi për namazin e natës përfshin përfitimet e kësaj bote dhe të botës tjetër.

Ibn Kajjim ka thënë: **“Katër vepra të mira sjellin furnizim: Namazi i natës, istigfari (kërkim falje në kohën e syfyrit, sadakaja/lëmosha, dhikri i mëngjesit dhe i mbrëmjes”**

Gjithashtu ka thënë: “Nuk ka dyshim se namazi, përveç se ruan shëndetin e shpirtit, forcon dhe mbron imanin, e bën njeriun të lumtur në këtë botë dhe në botën

NJERËZIT E DEVOTSHËM E KANË DITUR SE NAMAZI I NATËS, ËSHTË SHKOLLË E TË SINQERTËVE DHE KARVANI I MË TË MIRËVE, SEPSE ALLAHU I NDAN DHURATAT DHE THESARET E MIRËSISË SË TIJ NË THELLËSINË E NATËS PËR ATA QË GJUMIN E ZËVENDËSOJNË ME TË QËNDRUARIT ZGJUAR, NDËRSA I PRIVON TË SHKUDJESURIT DHE GJUMASHËT.



tjetër”, gjithashtu ruan shëndetin e trupit dhe ndihmon të lirohet nga substancat e panevojshme dhe të dëmshme.

Namazi i natës është një histori në vetvete. Ai është ilaçi më efikas për trupin, parandaluesi më i mirë i sëmundjeve kronike dhe stimuluesi më i mirë për trupin, zemrën dhe shpirtin.

Ata të cilët rregullisht kryejnë namazin e natës, janë fizikisht më të shëndoshë dhe shpirtërisht më të lumtur; fytyrat i kanë më të ndritura, të folurit e bekuar; veprat e tyre janë të

ndershme. Ata janë larg mashtrimeve, vetëkënaqësisë dhe kërkesave për t'u lavdëruar nga njerëzit. Janë më të ndaluarit nga mëkatet, më të heshturit e gjuhës, më ambicioz dhe këmbëngulës në kryerjen e veprave të mira.

Pejgamberi (a.s), siç thuhet në hadithin e transmetuar nga Aisheja, (r.a): “Kurrë nuk e ka lënë namazin e natës, e në qoftë se ka qenë i sëmurë, falej ulur”. - (Sahih, Ebu Davudi).

Ai i ka këshilluar shokët e tij të jenë të qëndrueshëm dhe të pa lëkundur në kryerjen e rregullt të këtij adhurimi.

Transmeton Abdullah ibn Amr ibn el-As, (r.a), se Pejgamberi (a.s), ka thënë: “O Abdullah, mos u bëni si ai dhe ky, një kohë e ka falur namazin e natës e pastaj e ka ndërprerë.”

Statusin e namazit të natës e ka çdo namaz, prej dy, katër ose më shumë rekatesh, i cili kryhet natën, në periudhën mes namazit të jacisë dhe namazit të sabahut.

Pejgamberi (a.s), e ka bërë këtë namaz të lejuar për të gjithë njerëzit, kështu që për të nuk është kushtëzuar leximi i një numri të caktuar ajetesh, qëndrimit të gjatë në këmbë apo diç tjetër, por ka porositur që të falet sipas mundësive.

Transmeton Abdullah ibn Amr ibn el-As, (r.a) se Pejgamberi (a.s), ka thënë: “Kush e fal namazin e natës me dhjetë ajete, nuk do të regjistrohet në grupin e te pakujdesshmëve; kush e fal namazin e natës me njëqind ajete do të regjistrohet në grupin e te bindurve, e kush e fal namazin e natës me njëmijë ajete, do të shënohet në “mukantirinë” – atyre të cilëve do t'ju jepet shpërblim i pakufishëm.” - (Sahih, Ebu Davudi).

Të gjithë ne, secili sipas mundësisë së tij, duhet të përpjekemi sa më shumë dhe rregullisht ta kryejnë namazin e natës, e motoja jonë le të jete: “E nëse i bindeni atij - d.m.th, Pejgamberit (a.s.) - do të jeni në rrugën e drejtë”.

(www.islamgjakova.net)

9. Kur'ani, El-Hashr: 18-19.

10. ES-Sujuti: Tarihu-l-hulefa, Dar Ibn Hazm, Bejrut, 2003, f. 57.

11. Kur'ani, En-Nas: 1.

12. Xhelaludin Rumi: Kitab fihî ma fihî, përktheu nga persishtja në anglisht: Isa Ali el-Akub, Darul-Fikril-Muasir, Bejrut, 2001, f. 334.

13. Kur'ani, Er-Ra'd: 11.

“MËSOJMË DHE ARGËTOHEMI”



S ektori i arsimit, pranë Myftinisë Shkodër gjatë muajit shkurt 2022 ka zhvilluar një sërë aktivitesh me nxënësit e kurseve fetare të xhamive Rragam, Gur i Zi, Golem dhe Barbullush.

Në aktivitetin e xhamisë Rragam, të datës 5 shkurt u përfshinë edhe nxënësit e xhamisë Gur i Zi, ku përmes programit “Mësojmë dhe argëtohemi” u zhvillua një aktivitet i larmishëm me praninë e mësuesve të tyre Taksim Plori dhe Ridvan Fregjaj.

I pranishëm në këtë aktivitet ishte edhe drejtuesi i arsimit, teologu Arben Halluni, i cili dha disa këshilla dhe udhëzime edukative të dobishme.

Më pas, programi vijoi me zhvillimin e një konkursi fetar, koktejl, lojëra të ndryshme sportive etj.

Aktiviteti tjetër vijues ishte më 11



AKTIVITETE TË LARMISHME ME XHAMITË RRAGAM, GUR I ZI, GOLEM, SHIRQ DHE BARBULLUSH

shkurt në Barbullush, ku pas faljes së xhumasë nxënësit e kurseve fetare, nën drejtimin e mësuesit të tyre, Elvis Molla u sensibilizuan në organizmin e pastrimit të ambienteve të jashtme, oborrit të saj dhe përgatitjen e hapjes së Qendrës Kulturore pranë xhamisë.

Ndërsa, më datën 12 shkurt midis nxënësve të xhamive Golem dhe Shirq-Mushan nën drejtimin e mësuesit të tyre, H. Kujtim Cufaj u zhvillua një aktivitet argëtues, lojra sportive, shëtitje, etj, në kompleksin “Zmijani”.

I pranishëm në këtë veprimtari ishte edhe teologu Arben Halluni, i cili mbajti një bisedë të shkurtër mjaft të vlefshme për këtë brez të ri, i cili kërkon një vëmendje të vazhdueshme nga të gjithë.

Programi i aktiviteteve: “Mësojmë dhe argëtohemi”, do të vijojë me të tjera xhami gjatë kësaj periudhe.



MYFTIU SYTARI MORI PJESË NË CEREMONINË E MENSURËS SË REISIT TË B.ISLAME NË MAL TË ZI



Me ftesë zyrtare të Bashkësisë Islame të Malit të Zi, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, mori pjesë të dielën, më 6 shkurt 2022, në ceremoninë e promovimit të Reisit të ri të Bashkësisë Islame të Malit të Zi, Rifat ef. Fejziq, e njohur si ceremonia e Menshurës, që u mbajt në xhaminë "Osmangazi" në Podgoricë.



Në këtë ceremoni morën pjesë përfaqësues të bashkësive islame dhe xhamive nga vende të ndryshme të Ballkanit, si nga: Shqipëria, Maqedonia e Veriut, Turqia, Bosnja dhe Hercegovina, Sllovenia, Sanxhaku, etj.

Me këtë rast, Myftiu i Shkodrës iu drejtua të pranishmëve me një mesazh urimi, duke u lutur që fryma e vëllazërisë dhe bashkëpunimit në mesin e muslimanëve në trojet tona të rritet dhe të dëshmohet, si një gjurmë qytetëruese në shërbim të vlerave të besimit, sigurisë dhe paqes sociale.

Ai uroi Reisin Fejziq për mbarësi dhe suksese në drejtimin e Bashkësisë Islame të Malit të Zi.

I nderuari Rifat ef. Fejziq e drejton institucionin e Bashkësisë Islame të Malit të Zi që nga viti 2003.



PEJGAMBERI (A.S) KA THËNË:

“

Asnjë njeri të mos

e ndalojë hejbjë (frika)

e njerëzve, për të thënë

të vërtetën, kur e sheh atë,

apo e dëshmon!

Sepse atij, as nuk

i afrohet exheli dhe as nuk

i largohet rrizku,

ose ta thotë të vërtetën,

apo t'ia përkujtojë

ndonjë të madhi!

”

(Transmetuar nga sahabiu i nderuar,
Ebu Seid El-Hudriu - hadith i saktë)

PËRURORHET QENDRA KULTURORE, "ÇELËSAT E TË MIRËS" NË BARBULLUSH

Në kuadër të Natës së Madhe të Israsë dhe Miraxhit, ditën e dielë, më 27 shkurt 2022, në fshatin Barbullush, u zhvillua ceremonia e përvitit të Qendrës Kulturore, "Çelësat e të mirës", pranë xhamisë së kësaj zone.

Nderonin me praninë e tyre: drejtuesi për Ballkanin i fondacionit "Rahmeh International" në Kuvajt, z. Isa Dhewadi, drejtori i fondacionit "Mirësia", z. Korab Kaja, drejtori i fondacionit "Mirënjohja", z. Samed Shehu, etj.

I pranishëm në këtë aktivitet ishte edhe kryetari i Komunitetit Mysliman, H. Bujar Spahiu, me bashkëpunëtorë, Myftiu i Malësisë së Madhe, H. Edmir



Smajlaj, si dhe drejtues të shoqatave islame brenda dhe jashtë Shqipërisë, imamë, besimtarë, etj.

Fillimisht, përshëndeti Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, i cili gjatë fjalës së tij tha: "Falënderoj donatorët nga Kuvajti, pikërisht fondacionin 'Rahmeh International', i cili afrohet këtë projekt bamirës arsimor

dhe kulturor për fëmijët e kësaj zone dhe jo vetëm, për të mësuar përmes kurseve fetare Kuranin, edukatën islame si dhe për të marrë mësimet dhe bekimet e shtëpisë së Zotit, për t'i përhapur më pas në realitetet e vendit tonë.

Në fakt, me këtë qendër po i bëjmë një shërbim të madh dhe të vyer Thirrjes Islame, po i bëjmë një shërbim të madh

xhamisë tonë, duke uruar dhe shpresuar që si institucione fetare të bëjmë përpjekjen e duhur që xhamitë e mëdha në zona të ndryshme të Shkodrës të kenë qendra të tilla kulturore dhe edukative".

Më pas, mbajti një fjalë përshëndetëse kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, i cili pasi falënderoi donatorët, shtetin dhe popullin e Kuvajtit për këtë dhuratë të bukur për zonën e Barbullushit, tha se KMSH-ja, do të ketë gjithmonë në vëmendje ndërtimin e xhamive dhe qendrave islame për të edukuar brezat me frymën e vërtetë islame, sipas traditës sonë dhe parimeve të harmonisë dhe paqes në mes njerëzve.

Përshëndetjet u mbyllën me urimet e drejtuesit për Ballkanin të fondacionit "Rahmeh International" z. Isa Dhewadi dhe drejtorit të shoqatës "Mirësia", z. Korab Kaja, të cilët falënderuan institucionet islame, KMSH-në dhe Myftininë Shkodër, për bashkëpunimin dhe mundësinë për të ofruar këtë bamirësi dhe qendër islame kulturore dhe edukuese për fëmijët dhe të rinjtë e kësaj zone me tradita fetare dhe kombëtare, por që do të shërbejë përveç zhvillimit të kurseve/mejtepeve fetare edhe për kurse sociale, profesionale, etj.

Momenti më i interesant i kësaj ceremonie ishte prerja e shiritit nga titullarët e institucioneve fetare, duke u shoqëruar me këndimin e ilahive dhe salavateve nga nxënësit e mejtepeve fetare të Barbullushit.

Autoritetet dhe të gjithë të pranishmit vizituan nga afër ambientet e brendshme dhe klasat e kësaj qendre të bukur me të gjitha kushtet bashkëkohore.





KOMUNITETI MYSLIMAN I SHQIPËRISE
MYFTINIA SHKODËR

"Këshilloji njerëzit

me vep'ra,

Jo me fjalë!

Hasan El-Basri

www.myftinia-shkoder.org



Botues:
Myftinia Shkodër
Drejtues:
Imam Muhamed Sytari

Kryeredaktor:
Lavdrim Hamja

Tel / Fax:
+355 (0) 224 2081
Nr. llogarie:
100054 UBA - Shkodër

 
MYFTINIASHKODER1990
udhaislame@myftinia-shkoder.org
www.myftinia-shkoder.org